



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**  
**DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has**

Krume, me 06.03.2020

**FTESË PËR OFERTË**

**Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri	Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has
Adresa	Rruga e Spitalit, Lagjia Nr 2, Qyteti Krume, Bashkia Has
Tel/Fax	+355 697998140
E-mail	spitalihas@shendetesia.gov.al
Personi përgjegjes	Erjola Cahani
Numri i References	REF-53236-03-06-2020

Autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: **Sherbime te dezinfektimit, deratizimit dhe dezinspektimit te ambjenteve te maternitetit te Spitalit Has**. Data e zhvillimit do të jetë **09.03.2020**, ora **10<sup>00</sup>** në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al). Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi.

Ofertuesi i renditur në vend të pare, duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor me mesazh elektronik ne sistem nepermjet skedarit “Kërkesat e Mia”, brenda 24 orësh, nga momenti i dërgimit të Njoftimit të Fituesit, ku te lajmeroje mbi realizimin ose pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

Bazuar ne pikën 14, të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, Nr. 3, datë 08.01.2018 *“Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”*, i ndryshuar, çdo ofertues do të verifikohet në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare te Biznesit. Në rast se pas verifikimit operatori ekonomik nuk rezulton me status aktiv dhe/ose nuk rezulton të ketë në fushën e veprimtarisë se tij objektin e prokurimit sipas Ekstraktit te Regjistrimit, oferta do te refuzohet automatikisht.

Gjithashtu, do të refuzohet automatikisht edhe oferta e paraqitur nga operatorë ekonomikë, të cilët në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor gjatë këtij viti, nuk ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë, mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

**Operatori ekonomik i renditur i pari, dhe qe merr përsipër realizimin e kryerjes së objektit të prokurimit, para se te shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentat si më poshtë:**

1. Formularin e ofertes ekonomike
2. Deklarate mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme
3. Deklarate per permbushjen e specifikimeve teknike
4. Deklarate mbi konfliktin e interesave
5. Deklarate per paraqitje oferte e pavaruar
6. Deklarate mbi garantimin e zbatueshmerise se dispozitave ligjore ne mardheniet e punes
7. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri
8. Liçense leshuar nga QKL në kategoritë II-8.A “Shërbime ekspertize higjeno-shëndetësore” dhe II-8.B “Shërbime ndërhyrëse higjeno-sanitare”

Ky përcaktim për paraqitjen e dokumentacionit të përshkruar më sipër, si dhe afati i paraqitjes, është i vlefshëm edhe për operatorët ekonomike nga i dyti në të dhjetin, në klasifikimin e ofertave.

Nëse dokumentacioni nuk është në përputhje me kërkesat e Autoritetit kontraktor, subjekti skualifikohet në vështrim të dispozitave të Ligjit “Për Prokurimin Publik”.

Afati i kryerjes së shërbimit është 3(tre) ditë duke filluar nga data e paraqitjes së operatorit ekonomik. Pas marrjes në dorezim të shërbimeve të dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit të ambjenteve, operatori ekonomik pajise institucionin me çertifikatën DDD.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit, si dhe dokumentacionin për pagesë, vërtetim, faturë si dhe IBAN.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Shaban PEKA**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

## FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has**

Procedura e prokurimit: **Prokurim me vlera te vogla me mjete elektronike**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Sherbime te dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit te ambjenteve te maternitetit te Spitalit Has**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

Çmimi total i ofertës sonë është [\_\_\_\_\_]; pa TVSH

Çmimi total i ofertës sonë është [\_\_\_\_\_]; me TVSH

Emertimi i sherbimit	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
Dezinfektim i ambjenteve ne maternitetin e Spitalit Has	m <sup>2</sup>	200		
Deratizim i ambjenteve ne maternitetin e Spitalit Has	m <sup>2</sup>	200		
Dezinfektim i ambjenteve ne maternitetin e Spitalit Has	m <sup>2</sup>	200		
		<b>Vlera</b>	<b>pa TVSH</b>	
		<b>TVSH</b>	<b>20%</b>	
		<b>Vlera</b>	<b>me TVSH</b>	

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

## **DEKLARATË**

### **Për paraqitje Oferte të Pavarur**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë **09.03.2020** nga Autoriteti Kontraktor **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has** me objekt: **Sherbime te dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit te ambjenteve te maternitetit te Spitalit Has.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: \_\_\_\_\_ që:  
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

---

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

---

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

**DEKLARATË  
Mbi  
PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë **09.03.2020** nga Autoriteti Kontraktor **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has** me objekt: **Sherbime te dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit te ambjenteve te maternitetit te Spitalit Has.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
  - Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
  - Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
  - Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
  - Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi
- Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË**  
**MBI**  
**GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E**  
**PUNËS**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë **09.03.2020** nga Autoriteti Kontraktor **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has** me objekt: **Sherbime te dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit te ambienteve te maternitetit te Spitalit Has.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**DEKLARATË**  
**Mbi konfliktin e interesave**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë **09.03.2020** nga Autoriteti Kontraktor **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has** me objekt: **Sherbime te dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit te ambjenteve te maternitetit te Spitalit Has.**

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr.9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.



Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

**DEKLARATË  
MBI  
PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë **09.03.2020** nga Autoriteti Kontraktor **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has** me objekt: **Sherbime te dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit te ambjenteve te maternitetit te Spitalit Has.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e \_\_\_\_\_ të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

## **Specifikimet teknike per realizimin e ketij sherbimi jane si meposhte:**

**Programi i dezinfektimit:** Procesi i dezinfektimit ndërmerret për asgjësimin dhe parandalimin e infestimit të insekteve zvarritëse të dëmshme (buburrecat, milingonat, mizat, grerëzat, furrëtare etj) që janë bartës të agjentëve të sëmundjeve ngjitëse, dezinfektimi do të kryhet me spërkatje me pompë me insekticide të miratuara në listën e përditësuar nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe Direktivës 98/8 të BE-së për produktet biocide për përdorim në shëndet publik.

**Programi i dezinfektimit:** Dezinfektimi i ambientit bëhet për parandalimin dhe asgjësimin e insekteve fluturuese, me qëllim të shkatërrimit të mikroorganizmave patogjene dhe parandalimit të sëmundjeve infektive në ambientet e ruajtjes së dokumentit arkivor për të mbrojtur shëndetin e personelit që punon dhe administron dokumentacionin që nxirret nga këto depo.

**Programi i deratizimit:** Deratizimi i ambientit do të kryhet duke instaluar në vendet, ku dyshohet prania e brejtësve, pajisjet monitoruese të pajisura me karrema joshëse (rodenticide të miratuara në listën e përditësuar nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe Direktivës 98/8 të BE-së për produktet biocide për përdorim në shëndet publik). Pas mbikqyrjes së ambientit, do të përcaktohen vendet e instalimit të pajisjeve rodenticide në ambientin e brendshëm të të dy depove arkivore.

Dezinfektimi te kryhet kunder mikrobeve, paraziteve dhe sporeve.

Dezinfektimi kunder insekteve fluturuese Brenda dhe jashte objektit + aparatura ne ambientet e jashtme

Dezinfektimi insekteve tokesore ne ambientet e brendshme

Deratizimi kunder brejtesve+montimi i kutive te monitorimit

Mbrojtja e perimetrit te jashtem nga (gjlperinjte, hardhucac, zhapiket etj)

Cdo produkt i perdorur duhet te jete i kompanive europiane dhe te shoqerohet me certifikataen e origjines dhe te jete i regjistruar ne Bashkimin European.

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**